

THIRRJE PËR PJESEMARRËS NË TRAJNIM

HETIMI DHE IDENTIFIKIMI I TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Kurs trajnimi simulues

18-21 tetor 2021

Prezenca e OSBE-së dhe Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit të OSBE-së kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore zhvillojnë, për herë të parë në Shqipëri, trajnimin simulues për profesionistë të fushave të ndryshme, të angazhuar në këtë fushë.

Nëse kryen detyra që lidhen me identifikimin, mbrojtjen dhe asistencën ndaj personave të trafikuar apo me hetimin e veprave penale të trafikimit, trajnimi simulues i OSBE-së mbi “Hetimin dhe identifikimin e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri” është një mundësi për të zgjeruar njohuritë në këtë fushë, nëpërmjet një metode trajnimi tërësisht novatore.

Trajnimi synon të përmirësojë hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore si dhe identifikimin, referimin e mbrojtjen e viktimave të këtij krimi.

MBI PROJEKTIN

Trajnimi simulues zhvillohet në kuadrin e projektit "Veprime kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri", pjesë e programit “Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria”, i cili zbatohet nga disa organizata ndërkombëtare e vendase dhe udhëhiqet nga UNICEF Albania nëpërmjet mbështetjes së qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Pjesë e këtij projekti

është dhe zhvillimi për herë të parë në Shqipëri i trajnimit simulues.

MBI TRAJNIMIN SIMULUES

Trajnimet e bazuara në ushtrimet simuluese kanë të bëjnë me të vepruarin në *situata reale* duke u dhënë mundësi pjesëmarrësve në trajnim që të provojnë vendimmarrjen në situata të ndryshme me të cilat përballen në punën e përditshme, por në të ashtuquajturin “mjedis të sigurt”, pa qenë nevoja që të shqetësohen për pasojat e veprimeve të tyre. Duke qenë një metodë trajnimi e fokusuar te pjesëmarrësi, ajo vendos pikërisht pjesëmarrësit në trajnim në qendër të procesit të të mësuarit (dhe jo trajnuesin).

Ndryshe nga mësimet e dhëna në klasat e zakonshme, trajnuesit ndërveprojnë me pjesëmarrësit më shumë si lehtësues.

Gjatë këtij trajnimi, pjesëmarrësit në trajnim merren me raste të simuluar të trafikimit të qenieve njerëzore të rikrijuara nga aktorë profesionistë. Pjesëmarrësve u kërkohet të reagojnë në një sërë ngjarjesh të skenarit (“të japin kontribute”), të kryejnë detyra konkrete, të shpjegojnë radhën e ngjarjeve, të rindërtojnë historinë mbi bazën e së cilës ndërtohet një rast, si dhe të përpunojnë të dhënat e hetimit.

QASJE NDËRSEKTORIALE DHE E BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT

Për të zbatuar legjislacionin përkatës në fushën e antitrafikimit, pjesëmarrësit duhet të komunikojnë dhe të koordinohen mes strukturave të ndryshme. Bashkëpunimi ndërinstytucional është thelbësor për arritjen e objektivave të trajnimit.

Trajnimi me bazë simulimin krijon mundësi për përvojë aktive dhe të drejtpërdrejtë, për të mësuar nga kolegët të së njëjtës fushë ose të fushave të ndryshme. Pjesëmarrja e një game të gjerë profesionistësh, si oficerët e sektorëve të ndryshëm të policisë, prokurorë, punonjës socialë, punonjës të mbrojtjes së fëmijës, si dhe përfaqësues të qendrave që asistojnë viktimat e trafikimit, mundëson trajtimin ndërsektorial të rasteve të trafikimit.

OBJEKTIVAT KRYESORE TË TRAJNIMIT

Qëllimi kryesor i simulimit është të trajtojë pjesëmarrësit në zbatimin efektiv të masave antitrafikim përmes një qasjeje ndërsektoriale dhe të bazuar në të drejtat e njeriut.

Objektivat e posaçëm të trajnimit janë:

- ✓ Të nxisë përdorimin e treguesve kryesorë për identifikimin e viktimave të trafikimit;
- ✓ Të zbatojë një qasje ndërsektoriale dhe të bazuar në të drejtat e njeriut në zbulimin e veprave penale të trafikimit të personave dhe në identifikimin e viktimave;
- ✓ Të nxisë hetimin financiar dhe bashkëpunimin mes strukturave ligjzbatuese dhe atyre të drejtësisë penale.

KONKRETISHT, NË TRAJNIMIN SIMULUES PJESËMARRËSIT DO TË:

- ✓ Marrin informacion mbi kornizën e përgjithshme ligjore të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe në lidhje me treguesit specifikë për të identifikuar format e ndryshme të krimit;
- ✓ Mësojnë si të zbatojnë në praktikë njohuritë e marra;
- ✓ Përfshihen në një ushtrim kompleks të bazuar në simulim për të identifikuar dhe hetuar trafikimin e personave, për të mbrojtur dhe ndihmuar viktimat e mundshme dhe viktimat e trafikimit.

ORGANIZIMI I TRAJNIMIT:

- Ky është një **ushtrim intensiv simulues**.
- Pjesëmarrësit do të duhet të punojnë nga ora 09:00 deri në 16:00 për raste të simuluar të trafikimit të personave, duke bashkëpunuar në një mjedis ndër sektorial.
- Personat e interesuar mund të aplikojnë për një profil specifik të roleve siç është renditur në SHTOJCËN 1 më poshtë, në përputhje me punën e tyre të vërtetë dhe profilin profesional.

SI MUND TË APLIKONI PËR TË MARRË PJESE NË TRAJNIM

Për të aplikuar, ju lutemi përdorni formularin në SHTOJCËN 2.

Afati i fundit për të aplikuar është 30 gusht 2021 *

**OSBE rezervon të drejtën për të vlerësuar edhe aplikime jashtë afatit në rast se ato janë të*

pamjaftueshme ose jashtë kritereve të përzgjedhjes.

KËRKESAT E PËRGJITHSHME, TERMAT DHE KUSHTET:

Kërkesat thelbësore

Pjesëmarrësit duhet të plotësojnë kërkesat thelbësore të mëposhtme për të aplikuar:

- ✓ **Integriteti** – Pjesëmarrësit duhet të mbajnë standardet më të larta të integritetit personal, paanësisë dhe vetëdisiplinës gjatë trajnimit simulues.
- ✓ **Aftësitë negociuese** – Pjesëmarrësit duhet të kenë aftësi të shkëlqyera negociuese dhe aftësi për të punuar profesionalisht në një mjedis ndërsektorial.
- ✓ **Aftësi kompjuterike** – Aftësitë në përpunimin e tekstit, llogaritjet dhe sistemet e postës elektronike janë thelbësore. Njohja e mjeteve të tjera të IT do të jetë e preferueshme.

Kriteret e përzgjedhjes

Vetëm aplikimet e pjesëmarrësve që plotësojnë kërkesat thelbësore të sipërpërmendura do të merren parasysh. Ato do të vlerësohen me kriteret e mëposhtme:

- ✓ Posti i punës lidhet drejtpërdrejt me çështje që kanë të bëjnë me identifikimin, referimin, asistencën dhe mbrojtjen e personave vulnerabël, viktima të mundshme dhe viktima të trafikimit; dhe/ose me hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të trafikimit të personave.
- ✓ Janë të disponueshëm të ndjekin një trajnim intensiv që zhvillohet përgjatë një kohëzgjatjeje prej 3 ditësh dhe zgjat nga ora 09:00 deri në 16:00.

Si mund të aplikoj?

- Së pari, zgjidhni pozicionin për të cilin dëshironi të aplikoni brenda ushtrimit të simulimit, që korrespondon me një nga kutitë në tabelën organizative (shih më poshtë SHTOJCA 1). Profili / roli i saktë i secilës pozicion përshkruhet më poshtë në një tabelë (shih SHTOJCA 1).
- Pastaj, plotësoni formularin (SHTOJCA 2) duke treguar pozicionin për të cilin

dëshironi të aplikoni.

- Në fund, dërgoni formularin e aplikimit (jo më vonë se data 30 gusht 2021) në adresën e e-mail: Kristina.Doko@osce.org

Ende nuk jeni i sigurt pse duhet të merrni pjesë?


Vizitoni faqen e internetit të OSBE-së <http://www.osce.org/projects/cthblix> për të gjetur informacion shtesë në lidhje me këtë nismë të OSBE-së.

Çfarë do të ndodhë më pas?

- Ne do të informojmë pjesëmarrësit e përzgjedhur jo më vonë se data 30 shtator 2021 dhe më pas do të organizojmë procedurat e pjesëmarrjes suaj në trajnim.
- Të gjitha kostot e pjesëmarrjes suaj në trajnim, përfshirë kostot e udhëtimit, nëse është e nevojshme, mbulohen nga OSBE-ja.
- Ju lutemi, vini re se ne, gjithashtu, do t'u dërgojmë pjesëmarrësve të zgjedhur dokumente që duhet të lexohen para trajnimit.

SHTOJCA 1 – PROFILI I PJESËMARRËSVE

ROLET E PJESËMARRËSVE NË TRAJNIM



SHTOJCA 2 – FORMULARI I APLIKIMIT

Ju lutem plotësoni të gjitha fushat e mëposhtme dhe dërgojeni këtë formular aplikimi jo më vonë se data 30 gusht 2021 në adresën: Kristina.Doko@osce.org

APLIKIM	
Apliko për pozicionin: (Referoju profilin të pozicionit sipas Shtojcës 1 më lart)	
Ju lutemi, përshkruani shkurtimisht përse jeni i përshtatshëm të merrni pjesë në këtë trajnim, duke treguar shkurtimisht se si lidhet puna juaj me masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore/mbrojtjen e viktimave të trafikimit:	
INFORMACION PERSONAL:	
EMRI	MBIEMRI

DATA E LINDJES	GJINIA
BASHKIA/QARKU/RRETHI GJYQËSOR ku punoni aktualisht	VENDBANIMI
TELEFON	E-MAIL
KENI NEVOJE PËR AUTORIZIM NGA DREJTUESI JUAJ PËR PJESEMARRJE NË TRAJNIM (Rretho përgjigjen)	
PO	JO
PUNA QË KRYENI AKTUALISHT (Titulli, institucioni, vendi)	
DËSHIRONI TË MERRNI PJESE NË TRAJNIM NË VEND APO ONLINE	